



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 05 Maj 2022

Nr: 155

V E N D I M

PËR

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË SHOYRTIMIT ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË ORGANIZATËS “QENDRESA QYTETARE” NDAJ Z. EDISON MEMOLLA, DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE DURRËS, ZYRËS VENDORE ARSIMORE RROGOZHINË, QENDRËS KULTURORE “HAXHI MEMOLLA”, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË FUSHATËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022”**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N :

Referuar nenit 19, pika 1 shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.



Data: 05 Maj 2022  
Nr. 155

“Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj z. Edison Memolla, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, Zyrës Vendore Arsimore Rrogozhinë, Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

Referuar nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 09.04.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

- 1- Komisioneri fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në KQZ.
- 2- Afati që ka KQZ-ja për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.
- 3- Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Lidhur me denoncimin e Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj z. Edison Memolla, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, Zyrës Vendore Arsimore Rrogozhinë, Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, nëpërmjet së cilit pretendohet se, *“Në datë 16.02.2022, është bërë inaugurimi i Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” nga kryetari i bashkisë Rrogozhinë në detyrë, z. Edison Memolla, i cili është gjithashtu edhe kandidat për këtë bashki i Partisë Socialiste, në zgjedhjet e 6 Marsit 2022, me pjesëmarrjen e Drejtorisë Arsimore, Kulturës dhe Sportit dhe nxënësve të shkollës. Inaugurimi i këtij objekti kulturor vjen vetëm 3 ditë para çeljes së fushatës zgjedhore në referim të vendimit nr. 2, pika 2, datë 22.01.2022, i Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, duke shkelur dispozitat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, konkretisht neni 3, pika 1.1/b dhe 1.1/d, duke promovuar një investim vendor me karakter social dhe kulturor, si objekt i rindërtuar për shkak të fatkeqësive natyrore.*

*Ndër të tjera shihet se në këtë aktivitet janë pjesëmarrës nxënësit e shkollës dhe orari i zhvillimit (ora 11:00) të këtij aktiviteti përkon me orarin mësimor.*

*Gjatë këtij takimi, siç vërehet nga statusi në profilin personal në “Facebook” të kandidatit, z. Memolla shkruan: “Ditën e sotme i paraprimë inaugurimit të godinës së re të qendrës së kulturës në mënyrën më të bukur. Pasi të kalojmë fazën e zgjedhjeve lokale, do të pritët shiriti simbolik për hapjen e qendrës. Falënderoj të gjithë ata që kontribuan për realizmin e këtij projekti. Falënderoj të gjithë pjesëmarrësit dhe nxënësit për aktivitetin e këndshëm me këngë, valle dhe recitime që kishin realizuar”.*

Veprimtaria e kryer është në kundërshtim me nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

## VENDOSI:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj z. Edison Memolla, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, Zyrës Vendore Arsimore Rrogozhinë, Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 05 Maj 2022

Nr. 155

“Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj z. Edison Memolla, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, Zyrës Vendore Arsimore Rrogozhinë, Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”